





EKONOMIA DHE BUXHETI

2014



Raporti Mujor

Shkurt, 2014

Kontakt:

e-mail: marsed.harizi@financa.gov.al

e-mail: ernil.sabaj@financa.gov.al

(website - www.financa.gov.al)

PËRMBAJTJA

VEÇORITË KRYESORE.....	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE.....	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL.....	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
ANEKSI STATISTIKOR.....	13


VEÇORITË KRYESORE

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin shkurt 2014 arriti në 118.72 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin shkurt ishte 1.9 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin shkurt 2014 ishte 102.75 lekë për dollarë dhe 140.32 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit shkurt shënuan kuotat 2.46 për ato 12-mujore, 1.87 për 6-mujoret dhe 1.53 për qind për depozitat 3-mujore dhe 2.51 për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 8.49 për qind për huatë 12-mujore dhe 8.77 për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3*, arriti në 1,140,6 miliardë lekë në muajin shkurt, duke shënuar një rritje prej rreth 2.0 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i pagesave* për gjithë vitin 2013 rezultoi me një suficit të përgjithshëm prej 104.4 milionë euro;
- *Situata Buxhetore* për periudhën janar - shkurt 2014 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 1.7 miliardë lekë, ose 82.3 për qind më pak e planit për këtë muaj (e cila ishte 9.5 miliardë).
- *Të ardhurat gjithsej* të realizuara gjatë periudhës janar - shkurt 2014, arritën në rreth 52.4 miliardë lekë, ose 102.4 për qind e planit për muajin.
- *Shpenzimet gjithsej* gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 54.1 miliardë lekë, ose 89.2 për qind e shpenzimeve të planifikuara për këtë muaj.

ZHVILLIMET EKONOMIKE

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin shkurt 2014 shënoi një rritje prej 1.4 për qind krahasuar me muajin janar '14, kur ky indeks shënonte një rritje prej 0.8 për qind, krahasuar me muajin paraardhës. Ndërsa gjatë muajit dhjetor '13, ky indeks ishte 1.7 për qind më i lartë se në muajin nëntor '13. Ndryshimet respektive me të njëjtët muaj të një



Ndryshimet mujore të IÇK-së

Burimi: INSTAT

viti më parë ishin 1.9 për qind, 1.7 për qind dhe 1.9 për qind. Rënia me e madhe mujore, gjatë muajit shkurt u konstatua në grupin “Veshje dhe këpucë” me 3.41 për qind. Pesha specifike relativisht e ulët që zë ky grup në shportën e mallrave të konsumit, bën që ndryshimet e çmimeve për këtë grup të kenë efekte të ulëta mbi normën e inflacionit (rreth 0.1 pikë përqindjeje). Ndërsa rritja më

e madhe u konstatua në grupin “Pije alkolike dhe duhan” me 6.3 për qind (duke kontribuar me 0.3 pikë përqindje në normën e inflacionit). Norma vjetore e inflacionit në muajin shkurt arriti në 1.9 për qind, duke qëndruar poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2013 dhe 2014 paraqiten në tabelën 1.


Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)

VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
2013	2.7	2.5	2.4	2.3	2.1	2.3
2014	1.7	1.9				
VITI	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2013	1.6	1.2	1.7	1.7	1.0	1.9
2014						

Burimi: INSTAT

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin shkurt 2014, arriti në 140.32 lekë/euro, duke shënuar një rënie me 0.16 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit shkurt, një euro u këmbye me 140.14 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin shkurt 2014, arriti në 102.75 lekë/dollarë duke



Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit shk'14

Burimi: Banka e Shqipërisë


shënuar një rënie prej 0.47 për qind kundrejt muajit janar'14. Në fund të muajit shkurt, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 101.58 lekë/dollarë. Në krahasim me muajin shkurt të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është mbiçmuar (mesatarisht) ndaj dollarit amerikan në masën 1.8 për qind, ndërsa kundrejt monedhës europiane euro është

nënçmuar me 0.4 për qind. Nënçmimi dhe mbiçmimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane euro dhe monedhës amerikane, në radhë të parë është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rënie mesatare duke arritur në rreth 0.732 euro/dollarë.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji, përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.


3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit shkurt 2014, normat e interesit të depozitave 12 mujore në lekë arritën kuotën e 2.46 për qind, duke shënuar një rritje me 0.07 pikë përqindje krahasuar me



muajin janar 2014. Rritje për këtë muaj ka patur edhe në normat e interesit të depozitave me afate të maturimit 1 dhe 3-mujore respektivisht me 0.08 dhe 0.22 pikë përqindje, duke shkuar përkatësisht në 2.51 dhe në 1.53 për qind. Rënie për këtë muaj nuk ka patur në asnjë prej normave të interesit të depozitave për të gjitha afatet e maturimit. Norma e interesit për depozitat me afat maturimi

6-mujor ka qëndruar në të njëjtin nivel me muajin e mëparshëm janar 2014 në nivelin 1.87 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kanë pësuar rënie normat e interesit të depozitave për të gjitha afatet e maturimit 1, 3, 6 dhe 12-mujore.




Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit shkurt pësoi një rënie me 0.18 pikë përqindje, duke arritur në 8.49 për qind nga 8.67 për qind që ishte në muajin janar 2014. Për këtë muaj, norma e interesit të huave 6-mujore pësoi një rënie me 0.59 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin shkurt arriti në 8.77 për qind.

Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit shkurt 2014, për bonot 12 dhe 6-mujore ishin përkatësisht 3.79 për qind dhe 3.52 për qind. Gjatë këtij muaji, vihet re një rënie në *yield*-et e bonove të thesarit për të gjitha afatet e maturimit 12-mujore, 6-mujore dhe ato 3-mujore, me respektivisht 0.03, 0.19 dhe 0.12 pikë përqindje.

4. Bilanci i Pagesave


Bilanci i pagesave për periudhën janar–dhjetor 2013 regjistroi një suficit të përgjithshëm prej 104.4 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në figurën 5, ku



Bilanci i Pagesave viti 2013

Burimi: Banka e Shqipërisë

kontributin më të madh në të e jep zëri i “Llogaria korrente” së bashku me nënzërat e saj, me -1,026.7 milionë euro, duke u ulur me 0.5% krahasuar me 12-mujorin e vitit 2012. “Llogaria kapitale dhe financiare” për 12-mujorin e vitit 2013-të rezultoi të jetë 815.8 milionë euro, ose gati 5.9% më e e ulët se në 12-mujorin e vitit 2012.




Llogaria Korrente viti 2013

Burimi: Banka e Shqipërisë

Kompozicioni i deficitit të llogarisë korrente prej -1,026.7 milionë euro, i shprehur sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për periudhën janar – dhjetor '13 rezultoi: (i) bilanci tregtar -1,799.3 mln euro, (ii) shërbime neto 8.9 mln euro, (iii) të ardhura neto -8.4 mln euro, (iv) transferta neto 702.1 mln euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në figurën 6.

5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar


Gjatë muajit shkurt 2014, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 34,533.1 milionë lekë krahasuar me shkurtin e vitit 2013. Kjo rritje ka



ardhur si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë me rreth 8,522.1 milionë lekë dhe të rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë, me rreth 26,011.0 milionë lekë.

Ecuria e M.V.N. të sistemit në shk'13 - shk'14

Burimi: Banka e Shqipërisë



Agregati M3 shk'13 - shk'14

Burimi: Banka e Shqipërisë


Në muajin shkurt '14 sistemi bankar rezulton me një rënie prej 584.5 milionë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin janar '14, rënie e cila erdhi si rezultat i rënies së nivelit të mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me rreth 4,719.3 milionë lekë. Efekti total rënës i mjeteve valutore neto të sistemit bankar është zvogëluar, si pasojë e rritjes së ardhur në mjetet valutore neto të bankave të nivelit të dytë,

me rreth 4,134.8 milionë lekë.

6. Kredia për Ekonominë

Teprica e kredisë për ekonominë për muajin shkurt 2014 arriti në 540.7 miliardë lekë. Rënia e tepricës së kredisë, krahasuar me fundvitin 2013 shënoi vlerën 7.2 miliardë lekë, me një rënie të lehtë prej rreth 1.3 për qind. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 59.7 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 322.7 miliardë lekë. Gjatë muajit shkurt 2014, zëri “Korporata të tjera jofinanciare”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 66.2 për qind ose 357.8 miliardë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin e 27.5 për qind ose 148.7 miliardë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 4.59 dhe 1.69 për qind apo 24.8 dhe 9.2 miliardë lekë.


Fig-9



Rritja e stokut total të kredive

Burimi: Banka e Shqipërisë

Fig-10



Përberja e kredive shk '14

Burimi: Banka e Shqipërisë


rezidentë” me rreth 33.1 për qind dhe nga “Korporata publike jofinanciare”, me 9.24 për qind. “Korporata të tjera jofinanciare” dhe “Sektorë të tjerë rezidentë” zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 73.16 për qind dhe rreth 23.76 për qind.

monedhave vazhdon të mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 59.7 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 322.7 miliardë lekë. Gjatë muajit shkurt 2014, zëri “Korporata të tjera jofinanciare”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 66.2 për qind ose 357.8 miliardë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin e 27.5 për qind ose 148.7 miliardë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 4.59 dhe 1.69 për qind apo 24.8 dhe 9.2 miliardë lekë.

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin shkurt '14, zëri “Korporata të tjera jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 55.8 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë

7. Oferta e Parasë


Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin shkurt ka shënuar një rënie krahasuar me muajin paraardhës janar 2014. Kjo ofertë arriti në rreth 1,140.6 miliardë lekë në fund të



Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

muajit shkurt '14 duke shënuar një rënie prej 4.42 miliardë lekë kundrejt nivelit të regjistruar në muajin janar '14. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 2.0 për qind, duke ruajtur kështu tendencën rritëse të shfaqur që nga mesi i dy viteve më përpara. Ndërsa krahasuar me muajin paraardhës janar '14, oferta e parasë pësoi një rënie të lehtë prej 0.4 për qind.



Raporti i Depozitave ndaj M3


Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar një rritje prej 12.2 miliardë lekë në krahasim me muajin shkurt 2013. Depozitat në valutë gjatë muajit shkurt '14 janë mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 87.1 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa tek depozitat në lekë sektori i individëve ka zënë rreth 89.5 për qind të tyre.

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit shkurt 2014, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 89.5 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 7.7 për qind dhe nga “Korporata jofinanciare publike”, me 1.8

Fig-13




Rritja e stokut total të depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 87.1 për qind dhe rreth 10.7 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 88.4 për qind e totalit (në lekë).

Në përgjithësi, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 836.2 miliardë) të depozitave totale, prej rreth 946.3 miliardë lekë në muajin shkurt 2014. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (86.6 miliardë), “Korporata jofinanciare publike” (13.7 miliardë) dhe “korporata të tjera financiare” (7.9 miliardë).

Fig-14



Përberja e depozitave shk '14

Burimi: Banka e Shqipërisë

“Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 1.8 miliardë në totalin e depozitave. Gjatë muajit shkurt 2014, krahasuar me një muaj më parë, niveli i përgjithshëm i depozitave pësoi një rënie prej 3.7 miliardë lekë, kjo si rezultat i

rënies së depozitave në valutë me rreth 4.5 miliardë lekë, ndërsa nga ana tjetër në zvogëlimin e këtij efekti rënës ndikoi rritja e depozitave në lekë me rreth 0.8 miliardë lekë.

SEKTORI FISKAL

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar - shkurt 2014 janë mbledhur rreth 52.4 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 54.1 miliardë lekë, që përfshijnë 51.5 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 2.6 milionë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 24.5% janë financim i brendshëm.

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 102.4% të të ardhurave buxhetore për planin e periudhës, ndërsa shpenzimet përbëjnë rreth 89.2% të këtij plani. Shpenzimet korrente

janë rreth 93.3% e planifikimit të periudhës të këtij zëri, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 47.8% të tij.


Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 34.5 miliardë lekë (ose rreth 99.7% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 1.3 miliardë lekë (ose rreth 95.9% e planit të periudhës). Kontributet e

sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 10.5 miliardë lekë (ose rreth 97.8% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 4.4 miliardë lekë (ose rreth 109.8% e planit të periudhës).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 51.5 miliardë lekë, 11.4 miliardë lekë (22.1% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 7.8 miliardë lekë (15.2%) për interesat, 3.2 miliardë lekë (6.3%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 112 milionë lekë (0.2%) për subvencione, 20.9 miliardë lekë (40.6%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 3.1 miliardë lekë (6.1%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 4.9 miliardë lekë (9.5%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 15.4% (shpenzime personeli), 16.9% (shpenzime për interesat), 9.1% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 7% (subvencione), 15.3% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 9.4% dhe 21.3% (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishte 2.2%, ndërsa financimi i huaj është 5.1% e planifikimit të tyre vjetor.

Fig - 15



Treguesit Fiskal, janar - shkurt 2014

Burimi: Ministria e Financave

2. Të Ardhurat sipas Burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar - shkurt 2014 ishin rreth 52.4 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 46.4 miliardë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 4.4 miliardë lekë.

Tab - 2 Të ardhurat gjatë janar - shkurt 2014 (në mld Lekë)

Burimi	shkurt '14	shkurt'13	Ndryshimi në (%)
TVSH	18.3	15.6	17.3
Tatimi mbi fitimin	2.4	2.4	0.0
Taksa doganore	0.8	0.7	14.3
Taksat nacionale	4.8	4.1	17.1
Akcizat	3.7	4.7	-21.3
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP)	4.6	4.9	-6.1

Burimi: Ministria e Financave: Statistika Fiskale Mujore: janar - shkurt 2014.

3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej 1.7 miliardë lekë, për periudhën janar - shkurt 2014, u mbështet në vlerën 2.6 miliardë lekë nga burime të brendshme dhe rreth 936 milionë nga burime të jashtme. Huamarrja e brendshme ishte mjeti kryesor i financimit të brendshëm (rreth 156% të totalit të huamarrjes së brendshme), ndërsa për financimin e huaj ishin ripagesat (rreth 148% të totalit të huamarrjes së huaj për periudhën janar - shkurt 2014).

Për muajin shkurt 2014, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 25.114 miliardë lekë.
- Realizimi i shpenzimeve në masën 29.107 miliardë lekë

Në realizimin e të ardhurave për muajin shkurt 2014, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat kapin shifrën e 22.5 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 27.2 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 1.9 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1

Muaji	Mujor (Monthly)						Mesatar Mujor (Monthly Average)						Vjetor (Annual)						Month
	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2009	2010	2011	2012	2013	2014	
Janar	0.4	0.9	0.8	0.7	1.0	0.8	0.40	1.00	0.80	0.71	1.00	0.80	2.1	3.6	3.3	1.6	2.7	1.7	January
Shkurt	0.7	1.1	2.3	1.3	1.1	1.4	0.55	1.02	1.55	1.01	1.05	1.10	1.9	4.7	4.5	0.6	2.5	1.9	February
Mars	0.6	0.1	-0.1	0.4	0.2		0.57	0.71	1.00	0.80	0.77		1.6	4.1	4.3	1.0	2.4		March
Prill	-0.1	-0.4	-0.6	-0.1	-0.1		0.40	0.42	0.60	0.58	0.55		1.9	3.7	4.1	1.6	2.3		April
Maj	-0.8	-1.2	-1.1	-0.8	-1.0		0.16	0.10	0.26	0.32	0.24		2.1	3.3	4.2	1.9	2.1		May
Qershor	-0.6	-0.7	-1.1	-0.8	-0.6		0.03	-0.04	0.04	0.12	0.19		2.3	3.2	3.9	2.2	2.3		June
Korrik	-0.7	-0.5	-0.7	-0.2	-0.8		-0.07	-0.10	-0.07	0.08	-0.03		2.2	3.4	3.6	2.7	1.6		July
Gusht	0.7	0.8	0.3	0.4	-0.1		0.03	0.01	-0.02	0.12	-0.04		2.2	3.5	3.1	2.8	1.2		August
Shtator	0.8	0.7	0.4	0.2	0.8		0.11	0.09	0.02	0.13	0.06		2.0	3.4	2.8	2.6	1.7		September
Tetor	0.4	0.2	0.4	0.2	0.1		0.14	0.10	0.06	0.14	0.07		2.3	3.0	3.0	2.4	1.7		October
Nëntor	0.4	0.2	0.1	0.2	-0.5		0.16	0.11	0.06	0.14	0.01		2.8	2.8	2.9	2.5	1.0		November
Dhjetor	1.6	2.2	1.0	0.9	1.7		0.28	0.28	0.14	0.20	0.15		3.7	3.4	1.7	2.4	1.9		December

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Source : INSTAT, Bank of Albania

Tab - 2

Kursi i këmbimit

Exchange rate

Lekë për njësi të monedhës së huaj (*Lek per unit of foreign currency*)

Monedha	2009	2010	2011	2012	2013	2014		Currency
						Jan	Feb	
<i>Mesatarja e periudhës</i>								<i>Average of period</i>
USD	94.98	103.94	100.90	108.18	105.67	103.24	102.75	USD
EURO	132.06	137.79	140.33	139.04	140.27	140.54	140.32	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>								<i>In the end of period</i>
USD	95.81	104.00	107.54	105.85	101.86	103.66	101.58	USD
EURO	137.96	138.77	138.93	139.59	140.20	140.44	140.14	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

	2009	2010	2011	2012	2013	2014		
Në përqindje						Jan	Feb	In percent
Norma e depozitave								Deposits rates
12-M	6.78	6.07	5.87	5.38	4.17	2.39	2.46	12-M
6-M	5.74	5.16	4.87	4.50	3.40	1.87	1.87	6-M
3-M	5.05	4.42	4.22	3.83	2.72	1.31	1.53	3-M
1-M	4.56	4.70	4.39	3.62	2.79	2.43	2.51	1-M
Norma e huasë								Lending rates
12-M	12.46	11.52	11.17	10.28	9.52	8.67	8.49	12-M
6-M	12.54	11.69	12.28	10.61	9.59	9.36	8.77	6-M
Norma e letrave me vlerë								Securities rates
Bono thesari 1/								Treasury bills 1/
3-M	6.30	5.29	5.31	5.03	3.40	3.36	3.24	3-M
6-M	7.52	6.41	6.23	5.65	3.54	3.71	3.52	6-M
12-M	9.14	7.09	6.95	6.37	3.66	3.82	3.79	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 4 TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2014

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2014

Të dhëna progresive (Progressive Data)		në milionë Lekë (in million Lek)		
Nr.	E M È R T I M I	Janar January	Shkurt February	ITEMS
	TOTALI TË ARDHURAVE	27,283	52,397	TOTAL REVENUE
I.	Të ardhura nga ndihmat	624	1,648	Grants
II.	Të ardhura tatimore	23,835	46,360	Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	17,043	34,483	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	8,981	18,289	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	1,007	2,363	Profit Tax
3	Akcizat	1,616	3,660	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	2,569	4,576	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	2,482	4,806	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	388	789	Customs Duties
II.2	Të ardhura nga Pushteti Vendor	796	1,340	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat)	154	340	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	304	329	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	338	671	Local Taxes
II.3	Të ardh nga fondet speciale	5,996	10,537	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	5,257	9,209	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetsor	735	1,319	Health insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	4	9	Revenues for property compensation
III.	Të ardhura Jotatimore	2,824	4,389	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë	165	320	Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	1,810	2,630	Income of budgetary institutions
3	Dividenti	498	498	Divident
4	Tarifat shërbimeve	139	404	Tariffs on services
5	Të tjera	212	537	Other/not allocated
	TOTALI I SHPENZIMEVE	24,962	54,069	TOTAL EXPENDITURE
I.	Shpenzime Korrente	24,284	51,447	Current Expenditures
I.1	Personell	5,645	11,391	Personnel expenditures
1	Paga	4,856	9,809	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	789	1,582	Social insurance contributions
I.2	Interesat	3,819	7,843	Interest
1	Të Brendshme	3,476	7,058	Domestic
2	Të Huaja	343	785	Foreign
I.3	Shpenzime Operative Mirëmbajtje	1,275	3,228	Operational & Maintenance
	Subveclonet	58	112	Subsidies
I.6	Shpenzime për fonde speciale	9,440	20,875	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	7,432	15,127	Social insurance
2	Sigurime Shëndetsore	2,008	4,754	Health insurance
I.7	Shpenzime per Buxhetin Vendor	1,214	3,116	Local budget expenditure
I.8	Shpenzime të tjera	2,833	4,882	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	112	198	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	2,721	4,684	Social assistance
5	Kompensimi i ish-të përndjekurve politike	300	300	Compensation for ex-political prisoners
III	Shpenzime Kapitale	678	2,622	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	0	641	Domestically financing
2	Financimi Huaj	678	1,981	Foreign financed
	DEFICITI	2,321	-1,672	CASH BALANCE
	FINANCIMI DEFICITIT	-2,321	1,672	CASH BALANCE FINANCING
	Brendshëm	-1,689	2,608	Domestic
	Të ardhura nga privatizimi	0	1	Privatization receipts
	Hua-marrje e brendshme	3,473	4,696	Domestic new borrowing (net)
	Nacionale	3,482	4,707	Other
	Lokale	-9	-11	Foreign
	Të tjera	-5,161	-2,089	Other
	Depozitë e Qeverisë në Bankën e Shqipërisë	1,838	4,269	Government deposits into the Central Bank
	Të tjera	-6,998	-6,357	Other
	Depozita e ISSH dhe ISKSH	-3,545	-3,102	Deposits of Socila and Health insurance
	Mjete në ruajtje	6	57	Preservation stock
	Nën-hua	314	369	On-Loan Principal
	Detyrim ndaj ISSH	-220	-99	Liabilities to SSI
	Të tjera (detyrime të përkohshme)	-3,553	-3,582	Other-Float
	I hua	-632	-936	Foreign
	Hua afatgjatë(e marrë)	198	599	Long-term foreign borrowing (gross)
	Nga e cila nën-hua	0	0	
	Ndryshimi i gjendjes së arkës*	-142	-150	Chang. of stat. Account
	Ripagesat	-688	-1,385	Repayments

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

"Chang. of stat. Account" stands for the change in Foreign Financing Deposit

* "Ndryshimi i gjendjes së arkës" përfaqëson ndryshimin e Depozitës së Financimeve të Huaja

Tab - 5

Tabela e investimeve 2014

Table of investments 2014

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million Lek)

	Janar January	Shkurt Feb	
Financim i brendshëm	0	641	Domestic financing
Në %	0.00	24.45	In %
Financim i huaj	678	1,981	Foreign financing
Në %	100.00	75.55	In %
Totali	678	2,622	Total
Në %	100	100	In %

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 6

TË ARDHURAT DOGANORE 2014 (CUSTOMS REVENUES 2014)

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million Lek)

	Janar January	Shkurt Feb	
Taksë doganore	388	789	Customs Duties
TVSH	6,102	12,817	V.A.T
Akcizë	1,616	3,660	Excises
Të tjera	612	1,153	Others
TOTALI	8,718	18,419	Total

TË ARDHURAT TATIMORE 2013 (TAX REVENUE)

TVSH	2,879	5,472	V.A.T
Akciza	0	0	Excises
Tatim mbi fitimin	1,007	2,363	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	2,568	4,575	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	1,870	3,653	National taxes
TOTALI	8,324	16,063	Total
TOTALI I PËRGJITHSHËM	17,042	34,482	OVERALL TOTAL

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 7

DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2014

The Deficit and Its Financing for 2014

Të dhëna progresive (Progressive Data)

Në milionë lekë (In million Leks)

	Janar January	Shkurt Feb	
TË ARDHURAT	27,283	52,397	REVENUE
SHPENZIMET	24,962	54,069	EXPENDITURES
BILANCI FISKAL	2,321	-1,672	FISCAL BALANCE
FINANCIMI I BILANCIT FISKAL	-2,321	1,672	FINANCING
Financimi i brendshëm	-1,689	2,608	Domestic
a. Bono Thesari Neto	793	2,101	Treasury bills
b. Obligacione	3,000	2,606	Bonds
c. <i>Ndryshimi i gjëndjes së arkës</i>	<i>-1,707</i>	<i>1,167</i>	Chang.of stat. account
Depozita e qeverisë në BSH	1,838	4,269	Deposit of Government in B.O.A
Depozita e ISSH dhe ISKSH	-3,545	-3,102	Deposit of Social & Health Ins.
Mjete në ruajtje	6	57	Non-budget revenues
Të ardhura nga privatizimi	0	1	Privatization receipts
Të tjera detyrime (të përkohshme)	-3,459	-3,312	Others
Huamarrje Brendshme Vendori	-9	-11	Local Borrowing
Financimi i jashtëm	-632	-936	Foreing
a. Hua afatgjatë	198	599	Long-term foreign borrowing (gross)
nga e cila: nën-hua	0	0	
b. Ndryshimi I gjëndjes së arkës	-142	-150	Chang. of stat. Account
Ripagesat	-688	-1,385	Repayments

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 8

BILANCI I PAGESAVE

Balance of payments

Në milion Euro

In millions Euro

	3M_J 2012	3M_II 2012	6M_J 2012	3M_III 2012	9M_2012	3M_IV 2012	Viti 2012	3M_J 2013	3M_II 2013	6M_J 2013	3M_III 2013	9M_2013	3M_IV 2013	Viti 2013	
Llogaria korente	-290.6	-251.80	-542.40	-242.80	-785.20	-236.20	-1,021.40	-228.80	-300.80	-529.60	-214.10	-743.70	-283.00	-1,026.70	Current Account.
Bilanci tregtar	-465.4	-475.50	-940.90	-540.50	-1,481.40	-517.80	-1,999.20	-336.20	-399.00	-735.20	-439.20	-1,174.40	-554.90	-1,729.30	Trade Balance.
Eksporti I mallrave fob	325.80	394.20	720.00	402.50	1,122.50	403.10	1,525.60	378.10	458.80	836.90	454.80	1,291.70	439.80	1,731.50	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-791.20	-869.70	-1,660.90	-943.00	-2,603.90	-920.90	-3,524.80	-714.30	-857.80	-1,572.10	-894.00	-2,466.10	-994.70	-3,460.80	Merchandise Imports. Fob
Bilanci I shërbimeve	8.40	26.20	34.60	132.70	167.30	27.90	195.20	-44.40	-37.20	-81.60	46.90	-34.70	43.60	8.90	Services Balance.
Shërbimet Kredi	293.80	381.10	674.90	578.10	1,253.00	402.10	1,655.10	283.50	346.90	630.40	526.50	1,156.90	498.10	1,655.00	Services Credit
Shërbimet Debi	-285.40	-354.90	-640.30	-445.40	-1,085.70	-374.20	-1,459.90	-327.90	-384.10	-712.00	-479.60	-1,191.60	-454.50	-1,646.10	Services Debt
Bilanci I të ardhurave	-40.40	-27.80	-68.20	-20.70	-88.90	-0.20	-89.10	-9.70	-21.80	-31.50	15.60	-15.90	7.50	-8.40	Balance of Incomes
Të ardhurat Kredi	48.20	43.00	91.20	57.80	149.00	55.30	204.30	42.20	47.10	89.30	52.20	141.50	51.80	193.30	Income Credit
Të ardhurat Debi	-88.60	-70.80	-159.40	-78.50	-237.90	-55.50	-293.40	-51.90	-68.90	-120.80	-36.60	-157.40	-44.30	-201.70	Income Debt
Bilanci I transfertave	206.80	225.30	432.10	185.70	617.80	253.90	871.70	161.50	157.20	318.70	162.60	481.30	220.80	702.10	Balance of Transfers
Transferta private	201.50	220.50	422.00	180.30	602.30	244.40	846.70	159.90	149.80	309.70	159.10	468.80	212.60	681.40	Private Unrequired Transfers
Transfertat shtetërore	5.30	4.80	10.10	5.40	15.50	9.50	25.00	1.60	7.40	9.00	3.50	12.50	8.20	20.70	Official Unrequired Transfers
Llogaria kapitale	12.90	43.00	55.90	9.80	65.70	15.60	81.30	9.70	4.80	14.50	15.00	29.50	18.20	47.70	Capital Account
Llogaria financiare	245.40	142.50	387.90	164.50	552.40	233.60	786.00	183.10	321.90	505.00	66.30	571.30	196.80	768.10	Financial Account
Investime direkte	202.80	190.80	393.60	156.90	550.50	176.70	727.20	194.10	239.30	433.40	266.40	699.80	193.30	893.10	Direct Investment
Investime portofoli	-46.40	29.50	-16.90	-18.60	-35.50	11.00	-24.50	-22.40	-100.20	-122.60	-4.20	-126.80	23.10	-103.70	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	89.00	-69.10	19.90	30.10	50.00	45.90	95.90	15.30	182.90	198.20	-192.40	5.80	-19.60	-13.80	Other Capital
Gabime dhe harresa neto	35.40	73.80	109.20	158.00	267.20	-36.20	231.00	12.40	60.50	72.90	167.30	240.20	75.10	315.30	Net errors and omissions
Bilanci I përgjithshëm	3.10	7.5	10.60	89.50	100.10	-23.2	-77.20	-23.6	86.4	62.80	34.50	97.30	7.10	104.40	Overall Balance
Rezervat	-3.20	-7.50	-10.70	-89.70	-100.40	23.20	-77.20	23.60	-86.40	-62.80	-34.50	-97.30	-7.10	-104.40	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	0.00	-8.70	-8.70	-3.90	-12.60	0.00	-12.60	-3.90	-0.10	-4.00	-3.50	-7.50	-0.30	-7.80	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 9 MJETET VALUTORE NETO
Net Foreign Assets

Në milionë Lekë	2009	2010	2011	2012	2013	2014		Millions of Lek End of Period
						Janar Jan	Shkurt Feb	
Fundi i periudhes								
Mjetet valutore neto	214,466.7	252,827.9	255,657.9	266,540.0	274,198.1	275,373.6	270,654.4	Net Foreign assets
Predendime ndaj jorezidentëve	236,223.3	274,628.2	276,475.7	288,142.1	294,111.3	295,512.5	290,692.1	Claims on non-residents
Minus: Detyrime ndaj jorezidentëve	21,756.6	21,800.3	20,817.8	21,602.1	199,13.2	20,138.9	20,037.7	Minus: Liabilities to non-residents
Mjetet e brendshme	105,263.2	72,244.4	84,492.3	78,858.1	67,841.8	65,447.6	67,580.0	Domestic Assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	71,369.7	57,937.1	57,098.0	55,145.6	44,503.1	43,451.9	45,018.8	
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore	82,289.4	66,928.8	67,590.8	68,057.8	66,768.8	65,104.8	65,050.2	Net Claims on Central Government
Minus: Detyrime ndaj qeverisë qendrore	10,919.7	8,991.7	10,492.8	12,912.2	22,265.7	21,652.9	20,031.4	Minus: Due to Central Government
Pretendime ndaj korporatave të tjera deponituese	32,372.6	12,535.6	25,485.8	21,800.8	21,502.9	20,164.6	20,743.2	Claims on other depository corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	Claims on other financial corporations
Pretendime ndaj korporateve jofinanciare publike	-	-	-	-	-	-	-	Claims on public non-financial corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare	-	-	-	-	-	-	-	Claims on other non-financial corporations
Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë	1,520.9	1,771.7	1,908.5	1,911.7	1,835.8	1,831.1	1,818.0	Claims on other resident sectors
Baza Monetare	284,839.7	283,453.5	289,809.0	297,721.9	308,073.7	305,263.0	303,750.8	Monetary Base
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	709.9	625.3	2,432.0	1,125.1	787.9	985.2	964.3	Deposits not included in broad money
Huatë	-	-	-	-	-	-	-	Loans
Llogari të pagueshme	720.6	797.9	901.1	1,306.1	1,309.8	1,322.4	1,340.5	Other accounts payable
Të tjera neto	-6,537.2	-12,051.3	-12,984.4	-14,702.6	-14,102.8	-14,307.3	-14,561.9	Other items net
Aksione	39,997.0	52,246.7	59,992.0	59,947.5	45,971.3	47,557.9	46,740.8	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 10 KREDIA PËR EKONOMINË
 Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2009	2010	2011	2012	2013	2014		Million of Lek End of Period
						Janar Jan	Shkurt Feb	
Totali i kredisë	440,397.4	483,044.8	541,899.9	554,732.2	547,927.6	544,569.6	540,743.1	Total Credit
Kredia për qeverinë lokale	-	-	147.20	193.9	256	249.3	247.7	Credits to local Government
Në Lekë	-	-	147.20	193.9	256	249.3	247.7	in Lek
Në valutë	-	-	-	-	-	-	-	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare publike	12,056.3	9,373.9	18,678.5	23,780.7	24,961	25,002.0	24,831.1	Credits to Public Non-financial Corporations
Në Lekë	6,323.5	5,022.9	8,446.2	18,474.3	20,251.4	20,270.8	20,157.6	in Lek
Në valutë	5,732.8	4,351.0	10,232.3	5,306.4	4,709.6	4,731.2	4,673.5	in Foreign Currency
Kredia për korporatat jofinanciare private	275,479.8	315,879.1	364,373.9	370,993.0	363,541.2	361,084.8	357,778.9	Credits to other Non-financial Corporations
Në Lekë	70,353.3	83,234.9	108,321.7	121,808.7	122,944.7	121,170.3	121,699.3	in Lek
Në valutë	205,126.5	232,644.2	256,052.2	249,184.3	240,596.5	239,914.5	236,079.6	in Foreign Currency
Kredia për korporatat e tjera financiare	6,032.3	8,704.5	9,841.9	10,162.9	9,578.2	9,299.3	9,157.3	Credits to Other Financial Corporations
Në Lekë	816.3	2,957.0	3,364.2	4,031.7	4,238.4	4,077.7	3,883.2	in Lek
Në valute	5,216.0	5,747.5	6,477.7	6,131.2	5,339.8	5,221.6	5,274.1	in Foreign Currency
Pretendime për sektorë të tjerë rezidentë	146,829.0	149,087.3	148,858.4	149,601.7	149,591.2	148,934.2	148,728.1	Claims to other Resident Sectors
Në Lekë	62,986.8	65,897.5	68,499.9	70,614.1	72,242.5	71,991.3	72,060.1	in Lek
Në valutë	83,842.3	83,189.8	80,358.5	78,987.6	77,348.7	76,942.9	76,668.0	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 1.1

OFERTA E PARASË

Money Supply

Mujor-Monthly

Në milion Lekë Fundit i periudhës	2009	2010	2011	2012	2013	2014		Millions of LEK End of Period
						Janar Jan	Shkurt Feb	
Baza monetare	284,839.7	283,453.5	289,809.5	297,721.9	308,073.7	305,263.0	303,750.8	Base Money
Ndryshimi vjetor në %	4.8	-0.5	5.4	2.7	3.5	7.0	6.8	Y/Y change in %
Paraja jashtë korporatave deponituese	209,043.8	195,059.0	194,923.4	192,705.1	198,892.7	195,004.0	194,266.0	Currency Outside Depository
Ndryshimi vjetor në %	6.8	-6.7	-0.1	-1.1	3.2	5.6	4.9	Y/Y change in %
Depozita	662,425.7	785,225	875,230	930,703	950,088.4	949,980.1	946,301.8	Deposits
Ndryshimi vjetor në %	6.9	18.5	10.5	6.3	2.1	2.3	1.4	Y/Y change in %
Agregati M1	284,505.6	275,427.3	276,898.3	281,246.6	295,876.5	291,905.9	292,215.1	M1 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	0.6	-3.2	0.5	1.6	5.2	9.0	8.0	Y/Y change in %
Agregati M2	578,181.5	604,517.3	647,007.8	669,577.1	693,172.2	687,566.0	687,588.6	M2 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	4.2	4.6	7.0	3.5	3.5	4.1	3.2	Y/Y change in %
Agregati M3	871,469.5	980,283.9	1,070,153.7	1,123,407.8	1,148,980.9	1,144,984.2	1,140,567.8	M3 Aggregate
Ndryshimi vjetor në %	6.8	12.5	9.2	5.0	2.3	2.8	2.0	Y/Y change in %
Burimet e bazës monetare								Monetary Base sources
Mjetet e huaja neto	214,466.8	252,827.8	255,657.9	266,540.0	274,198.1	275,373.6	270,654.4	Net foreign assets
Mjetet e brendshme neto	105,263.2	72,244.3	84,492.3	78,858.1	67,841.8	65,447.6	67,580.0	Domestic assets
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore neto	71,369.8	57,937.1	57,098.1	55,145.6	44,503.1	43,451.9	45,018.8	Net Claims on central government
Pretendimet ndaj korporatave të tjera deponituese	32,372.6	12,535.6	25,485.8	21,800.8	21,502.9	20,164.6	20,743.2	Claims on other depository corporations

Burimi : Banka e Shqiperisë

Source : Bank of Albania

Tab - 12

DEPOZITAT

Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2009	2010	2011	2012	2013	2014		Millions of Leks End of Period
						Janar Jan	Shkurt Feb	
Në lekë	369,138	409,459	452,085	476,872	494,279.5	492,562	493,323	In national currency
Depozitat e transferueshme +Depozita me likuiditet të lartë (depozita pa afat)	61,372	80,369	81,975	88,541	96,983.9	96,902	97,949	Transferable deposits+Liquid deposits
Qeveria lokale	478.1	948.1	1,157.4	1,059.7	1,305.0	1,595.0	1,525.8	Local governments
Korporata jofinanciare publike	7,687.7	7,134.0	7,303.4	7,168.0	6,108.2	7,194.9	6,758.6	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	675.3	920.6	532.5	1,789.2	937.0	728.5	838.7	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	20,574.7	22,505.0	20,681.5	24,716.6	24,244.0	22,288.2	23,130.7	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	31,956.3	48,860.8	52,300.1	53,807.9	64,389.7	65,095.4	65,695.3	Other resident sectors
Depozita të tjera	293,676	329,090	370,110	388,331	397,295.6	395,660	395,374	Other deposits
Qeveria lokale	8.4	55.1	109.6	19.4	57.1	60.8	59.5	Local governments
Korporata jofinanciare publike	3,378.4	3,054.3	2,608.9	1,715.4	1,257.8	659.7	2,242.6	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	786.6	1,773.4	1,423.5	2,224.4	2,556.5	3,619.2	2,079.2	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	9,898.3	8,316.8	11,292.5	10,954.1	14,523.4	14,577.4	15,042.6	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	279,604.3	315,890.5	354,675.1	373,417.3	378,900.8	376,742.9	375,949.6	Other resident sectors
Në valutë	293,288	375,767	423,146	453,831	455,808.9	457,418	452,979	In foreign currency
Qeveria lokale	313.0	493.0	280.5	44.5	372.6	254.3	229.1	Local governments
Korporata jofinanciare publike	6,771.0	6,201.0	5,242.2	4,011.2	4,486.2	4,892.6	4,670.0	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	3,672.8	8,572.0	6,022.3	6,303.3	6,673.1	5,435.3	5,031.1	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	39,582.9	57,382.9	54,418.4	46,867.5	49,382.3	50,422.4	48,444.0	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	242,948.4	303,117.7	357,182.4	396,604.2	394,894.7	396,413.5	394,605.0	Other resident sectors
Totali	661,626	785,225	875,230	930,703	950,088.4	949,980	946,302	Total
Qeveria lokale	799	1,496.2	1,547.5	1,123.6	1,735	1,910.1	1,814.4	Local governments
Korporata jofinanciare publike	17,837	16,389.3	15,154.5	12,894.6	11,852.2	12,747.2	13,671.2	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	5,243	11,266.0	7,978.3	10,316.9	10,166.6	9,783.0	7,949.0	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	70,361	88,204.7	86,392.4	82,538.2	88,149.7	87,288.0	86,617.3	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	568,186	667,869.0	764,157.6	823,829.4	838,185.2	838,251.8	836,249.9	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 13

BILANCI I PËRMBLEDHUR I BSH
 Consolidated BoA Balance sheet

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2009	2010	2011	2012	2013	2014		Millions of Lek End of period
						Janar Jan	Shkurt Feb	
AKTIVET	359,552	368,032	384,581	394,834	398,814	397,207	393,089	ASSET
Total	62,644	50,480	48,572	48,288	40,652	41,654	40,525	Total
Mbajtjet e SDR	7,546.1	8,126.9	8,226.5	8,789.7	10,508.0	10,521	11,182	SDR holdings
Arka në valutë	705.8	647.0	59.8	67.5	57.3	40	40	Foreign currency
Depozitat	54,392	41,705.7	40,286	39,431.1	30,086.2	31,092	29,302	Deposits
Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet	243,143	280,301	284,210	294,007	308,387	308,526	304,427	Securities other than shares
Jorezident	165,853.4	215,901.8	219,718.8	229,313.1	243,178.6	243,467	239,599	nonresidents
Qeveria qendrore	77,289.4	64,399.2	64,490.8	64,694.1	65,208.4	65,059	64,828	central government
Huatë	33,885	14,302	27,388	23,707	23,333	21,989	22,556	Loans
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera deponituese	32,371.7	12,534.8	25,485.4	21,800.2	21,502.3	20,164	20,743	Other depository corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	1,513.5	1,767.3	1,902.8	1,906.5	1,830.9	1,825	1,813	Other resident secotrs
Derivatet financiare	10.7	81.4	35.3	14.2	31.5	21	15	Financial derivatives
Llogari të arketueshme	13,279.2	10,748.3	11,295.9	14,129.2	11,994.1	10,597	10,953	Receivable accounts
Mjetet jofinanciare	6,590.9	12,119.1	13,080.0	14,688.0	14,416.4	14,420	14,614	Nonfinacial assets
DETYRIMET	359,552	368,032	384,581	394,834	398,814	397,207	393,090	LIABILITIES
Total	216,768	202,644	203,009	201,086	208,042	206,470	203,880	Total
Para në qarkullim	216,767.6	202,386.7	202,906.6	200,898.7	207,792.7	203,946	203,205	Currency in Circulation
Depozitat e përfshira në paranë e gjerë	0.6	256.8	102.8	187.3	249.7	2,524	675	Deposits included in broad money
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	87,661	98,842	108,017	120,691	132,765	131,075	130,454	Deposits excluded from broad money
Jorezident	7,981.6	8,440.3	8,318.7	10,042.9	9,706.5	9,665	9,608	Nonresidents
Qeveria qendrore	10,897.5	8,966.2	10,465.6	12,887.1	22,239.2	21,632	20,010	Central government
Korporata të tjera deponituese	68,071.5	80,810.0	88,570.2	97,054.7	100,031.3	98,793	99,871	Other depository corporations
Korporata të tjera jofinanciare	17.0	14.9	20.5	37.2	62.5	65	66	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	692.9	610.4	641.5	669.2	725.4	920	898	Other resident sectors
Huatë	1,269	5,921	4,852	3,871	2,919	2,866	2,627	Loans
Jorezidentët	1,269.2	5,920.6	4,852.0	3,870.7	2,919.3	2,866	2,627	Nonresidents
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera deponituese	-	-	-	-	-	-	-	Other depository corporations
Llogari të pagueshme	6,903.5	936.4	1,064.3	1,680.5	1,828.3	1,839	2,115	Other accounts payable
Alokimi i SDR	6,954.1	7,439.5	7,647.1	7,557.9	7,287.5	7,399	7,274	SDR allocation
Aksione dhe instrumenta të tjerë	39,997	52,249.7	59,992	59,947.5	45,971.3	47,558	46,741	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania